

SYLLABUS

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Menaxhmentit
Programi:	Menaxhmenti i Biznesit dhe Ndërmarrësia
Titulli i lëndës:	Gjuhë angleze III
Niveli:	Bachelor
Statusi i lëndës:	O
Viti i studimeve:	II
Semestri:	IV
Numri orëve në javë:	2
Vlera në kredi – ECTS:	3
Koha / lokacioni:	UShAF
Mësimdhënësi i lëndës:	
Detajet kontaktuese:	
Përshkrimi i lëndës	Lënda Gjuhë angleze III synon të ndihmojë studentët të zotërojnë aftësi të avancuara të komunikimit në gjuhën angleze në kontekste biznesi. Duke përdorur Business Result: Advanced si tekstin kryesor, kursi fokusohet në marrjen e vendimeve strategjike, mendimin kritik dhe udhëheqjen e diskutimeve në kontekste biznesi. Temat përfshijnë menaxhimin e krizave, inovacionin dhe krijimin e rrjeteve profesionale. Studentët do të zhvillojnë aftësi të artikullimit të ideve komplekse në mënyrë të rrjedhshme dhe të sigurt, si në të shkruar, ashtu edhe në të folur, duke i përgatitur ata për role udhëheqëse në biznesin global.
Qëllimet e lëndës	Qëllimi kryesor i këtij kursi është të ofrojë aftësi të avancuara të anglishtes së biznesit, duke i përgatitur studentët për role udhëheqëse dhe strategjike në mjedise profesionale. Theksi vihet në zhvillimin e aftësisë për të artikuluar ide të sofistikuara, për të udhëhequr diskutime dhe për të menaxhuar situata të rëndësishme në mjedise pune. Kursi fokusohet në përmirësimin e mendimit kritik, zgjidhjes së problemeve dhe strategjive të komunikimit, duke i mundësuar studentëve të përballojnë me vetëbesim sfidat globale të biznesit dhe të përdorin gjuhë dhe fjalor adekuat në kontekste sipërmarrëse.
Rezultatet e pritura të mësim-nxënies	Pas përfundimit të modulit studentët do të jenë të aftë që: 1. të hartojnë dokumente cilësore biznesi, duke përfshirë plane strategjike dhe propozime të ndryshme. (0.5 ECTS), 2. të udhëheqin diskutime dhe të prezantojnë ide komplekse në mënyrë të rrjedhshme dhe bindëse. (0.5 ECTS), 3. të vlerësojnë në mënyrë kritike materiale të ndryshme si diskutime paneli dhe prezantime konferencash. (1 ECTS), 4. të analizojnë dhe sintetizojnë informacione nga tekste të avancuara biznesi si raportet kërkimore dhe artikujt akademikë. (1 ECTS),

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrimet teorike/detyra	0	0	0
Punë praktike	0	0	0
Kontaktet me mësimdhënësit – konsultimet	1	10	10
Përgatitja për detyra projekte	0	0	0
Projekt kursi (planifikim + zbatim)	1	1	1
Detyra të shtëpisë	1	8	8
Koha e studimit vetanëk të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)			20
Përgatitja përfundimtare në provim	2	1	2
Koha e kaluar në vlerësim (teste, provim final)	2	2	4
Projektet, prezantimet etj	0	0	0
Totali			75
Metodologjia e mësimdhënies dhe mësim-nxënies	Ky kurs përqendrohet në aplikimin praktik të njohurive gjuhësore përmes projekteve në grup, rasteve të studimit dhe ushtrimeve role-playing. Metodot interaktive të mësimdhënies sigurojnë që studentët të mund të zbatojnë menjëherë atë që mësojnë në situata të ngjashme me ato reale të biznesit, duke nxitur mendimin kritik dhe bashkëpunimin mes vete.		
Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë	Metoda-Vlerësimi i studentëve në këtë lëndë bëhet në bazë të: ◆ Angazhimit në mësim:.....10% ◆ Testit gjysmësemestral:.....30% ◆ Testit përfundimtar, provimit:.....60% Kriteret e kalueshmërisë: 1. Angazhimi në mësim (10%): Ky komponent përfshin pjesëmarrjen aktive në ligjërata dhe ushtrime praktike, kontributin në diskutime, si dhe kryerjen e detyrave të shkurtra gjatë ligjëratës. 2. Testi gjysme-semestral (30%): Testi zhvillohet në mesin e semestrit dhe vlerëson njohuritë e fituara deri në atë pikë. Testi përfshin pyetje me alternativa, pyetje me përgjigje të shkurtra e të tjera që testojnë njohuritë e fituara të studentëve. 3. Testi përfundimtar / Provimi (60%): Ky test i zhvilluar në fund të semestrit mbulon materialin e lëndës të zhvilluar pas testit gjysmë-semestral. Pyetjet e testit përfundimtar janë të ngjashme, për nga forma, me ato të testit gjysmë-semestral. Studenti e kalon provimin nëse grumbullon 50 pikë (%) nga të gjitha aktivitetet e parapara me metodën e vlerësimit,		

	Notat në UShAF: <table><tr><th>Nota</th><th>ECTS/Nota</th><th>Përqindja (%)</th><th>Përkufizimi</th></tr><tr><td>10</td><td>A</td><td>90 - 100</td><td>Shkëlqyeshëm</td></tr><tr><td>9</td><td>B</td><td>80 - 89</td><td>Shkëlqyeshëm</td></tr><tr><td>8</td><td>C</td><td>70 - 79</td><td>Shumë mirë</td></tr><tr><td>7</td><td>D</td><td>60 - 69</td><td>Mirë</td></tr><tr><td>6</td><td>E</td><td>50 - 59</td><td>Mjaftueshëm</td></tr><tr><td>5</td><td>FX/F</td><td>0 - 49</td><td>Pamjaftueshëm</td></tr></table>	Nota	ECTS/Nota	Përqindja (%)	Përkufizimi	10	A	90 - 100	Shkëlqyeshëm	9	B	80 - 89	Shkëlqyeshëm	8	C	70 - 79	Shumë mirë	7	D	60 - 69	Mirë	6	E	50 - 59	Mjaftueshëm	5	FX/F	0 - 49	Pamjaftueshëm
Nota	ECTS/Nota	Përqindja (%)	Përkufizimi																										
10	A	90 - 100	Shkëlqyeshëm																										
9	B	80 - 89	Shkëlqyeshëm																										
8	C	70 - 79	Shumë mirë																										
7	D	60 - 69	Mirë																										
6	E	50 - 59	Mjaftueshëm																										
5	FX/F	0 - 49	Pamjaftueshëm																										
Mjetet e konkretizimit – TI	Përdorimi i SMART - tabelës, laptop, PowerPoint, Përdorimi i platformave dhe mjeteve “on-line” për të mbështetur komunikimin dhe bashkëpunimin në ekip, etj.																												
Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit	Teori: 60%; Praktikë (me ushtrime): 40% Ky raport ka për qëllim të sqarojë ngarkesën mësimore në kuadër të lëndës Gjuhë angleze I, e cila ka vlerë prej 3 ECTS që korrespondojnë me gjithsej 75 orë pune të studentit gjatë semestrit. Nga këto, 30 orë realizohen përmes ligjëratave në klasë, të përqendruara në zhvillimin e njohurive gjuhësore dhe terminologjisë së biznesit, ndërsa pjesa tjetër prej 45 orësh përfshin aktivitete të tjera si konsultime me mësimdhënësin (10 orë), detyra të shtëpisë (8 orë), vetë-studim (20 orë), si dhe përgatitje dhe vlerësim përfundimtar për provim (7 orë). Ndarja bëhet sipas raportit 60% teori dhe 40% praktikë: 45 orë / 2 ECTS i dedikohen pjesës teorike, që përfshin ligjëratat dhe studimin e pavarur me fokus në konceptet dhe strukturat bazë të gjuhës angleze. 30 orë / 1 ECTS i kushtohen pjesës praktike, duke përfshirë konsultimet, detyrat, diskutimet dhe vlerësimet, të cilat ndihmojnë studentët të zbatojnë njohuritë e fituara në situata konkrete të komunikimit akademik dhe profesional..																												
Literatura																													
Literatura bazë	1. Business Result Advanced by Kate Baade, Christopher Holloway, John Hughes, Jim Scrivener & Rebecca Turner. 2018.																												
Literatura shtesë																													
Plani i dizajnuar i mësimi:																													
Java	Ligjërata që do të zhvillohet																												
Java e parë	Hyrje në lëndë, diskutim i syllabusit dhe materialit mësimor																												
Java e dytë	Unit 1: Connections Describing cross-cultural experiences; Reporting back on research; Tenses review; Introducing yourself to a group; Talking point: Working in multinational teams																												
Java e tretë	Unit 2: Careers Comparing career paths; Managing the discussion/ Sharing ideas; Expressing attitudes to the past; Getting your point across; Talking point: Working in multinational teams																												
Java e katërt	Unit 3: Change																												

	Discussing working practices; Giving a formal presentation; Speculating about future changes; Showing understanding; Viewpoint 1: Dealing with change (video)
Java e pestë	Unit 4: Risk Handling a corporate crisis; Taking part in a teleconference; Referencing using pronouns; Establishing rapport; Talking point: Planning for the Olympics
Java e gjashtë	Unit 5: Teamwork Exploring team relationships; Dealing with conflict; Adding emphasis; Responding to feedback; Talking point: Problem-solving in a team
Java e shtatë	Unit 6: Progress Discussing factors for success; Brainstorming ideas; Using adverbs to qualify attitudes; Using vague language; Viewpoint 2: Ethical consumption (video)
Java e tetë	Mid-term test
Java e nëntë	Unit 7: Learning Talking about training and learning; Communication strategies; The future in the past; Expressing dissatisfaction; Talking point: Learning by sharing
Java e dhjetë	Unit 8: Performance Employer-employee expectations; Giving an impromptu presentation; Using questions; Dealing with difficult questions; Talking point: Rethinking annual performance reviews
Java e njëmbëdhjetë	Unit 9: Resources Corporate Social Responsibility; Discussing options; Using conditionals; Dealing with misunderstandings; Viewpoint 3: Business education
Java e dymbëdhjetë	Unit 10: Leadership Talking about leadership styles; Giving a briefing; Using the passive; Expressing personal views; Talking point: Leading your leaders
Java e trembëdhjetë	Unit 11: Values Talking about values; Reaching agreement; Participle clauses and inversion for emphasis and formality; Raising a difficult point; Talking point: Blowing the whistle
Java e katërbëdhjetë	Unit 13: Persuasion Persuasion and influence; Selling an idea; Discourse markers; Giving and responding to compliments; Viewpoint 4: Leading the future
Java e pesëmbëdhjetë	Rishikim i materialit dhe përgatitje për provim
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes	
Studenti është i obliguar t'i vijojë ligjëratat më rregull dhe të ketë sjellje korrekte ndaj kolegëve dhe stafit të Universitetit, mbajtja e qetësisë dhe angazhimi aktiv në ligjëratat dhe ushtrime është e obligueshme. Gjatë orëve të ligjëratave dhe ushtrimeve NDALOHET ushqimi, pëshpërimat që pengon punën në klasë dhe përdorimi i telefonave mobil. Njëkohësisht, telefonat celularë duhet të fiken ose të vihen në heshtje dhe të mos përdoren gjatë kohës së ligjëratave apo ushtrimeve. Mungesa e integritetit akademik (ku përfshihet plagjiatura, kopjimi i punës së një personi tjetër, përdorimi i ndihmave të paautorizuara në provime, mashtrimi etj) nuk do të tolerohet. Nëse ka dyshime për vërtetësinë e punës së paraqitur, mësuesi ka të drejtë t'i kërkojë studentit të verifikojë punën e tij/saj. Kjo mund të bëhet përmes: përsëritjes së punës, testimit me shkrim ose me gojë, kuiz i papritur apo me çdo veprim tjetër që konsiderohet i nevojshëm nga ligjëruesi.	